



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 37/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Gojart Lubeniqit, në cilësinë e kryetarit të ish subjektit politik Demokracia e Re e Kosovës (DRK), paraqitur kundër vendimit të ish – Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), Anr. 79/2010, të datës 23.02.2010, në seancën e panelit të mbajtur me 11.04.2013, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet poshtë apeli si i pasafatshëm.

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një apel më datë 27.02.2013, nga Gojart Lubeniqi, në cilësinë e kryetarit të ish subjektit politik DRK në të cilën thekson se ai nuk është kryetar i subjektit politik DRK dhe se tashmë ky subjekt politik nuk ekziston, pasi që ka 1 (një) vit e gjysmë që është shuar.

Parashtruesi i apelit kërkon që të lirohet nga gjoba e shqiptuar ndaj ish subjektit politik DRK pasi që ai nuk jeton më në Kosovë dhe se rastësisht ka qëlluar të jetë në Kosovë.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën ma të duhur si apelim.

Në nenin 8 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, përcaktohet afati kohor kur pala ka të drejt të paraqes një apel ndaj vendimeve të ish KZAP-it apo të PZAP-it, i cili afat ishte 72 orë nga pranimi i vendimit të PZAP-it nga parashtruesi, gjë që parashtruesi i apelit nuk e ka shfrytëzuar këtë periudhë kohore për ta apeluar vendimin.

PZAP-i, duke u bazuar në nenin 8 par. 5 dhe 9 par. 2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, gjeti se apeli është i pasafatshëm, sepse vendimi i ish KZAP-it e tani me emërtim të ri PZAP, Anr. 79/2010 është marrë me datën 23.02.2010, ndërsa apeli ndaj këtij vendimi është parashtruar në PZAP më datë 27.02.2013, që do të thotë se ka kaluar çdo afat ligjor për apelim.

Andaj duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 37/2013 më datën 11.04.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

